



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM - ERZEN TIRANË

Nr 07 / prot
3

Datë 07 / 07 / 2018

VENDIM
Nr 42 datë 27 / 11 / 2018

PËR
MIRATIMIN E LEJES PËR HAPJEN E NJË PUS-SHPIMI, BULEVARDI VERIOR I
TIRANËS, BASHKIA TIRANË, PËR QËLLIME UJITJE

Në zbatim të ligjit Nr.111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" të ndryshuar përkatësisht neni 50 pika 2 dhe neni 56 pika 2; Vendimit Nr. 416 datë 13.5.2015 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", Vendimit nr.5 datë 16.02.2016 për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor", Vendimit nr.6 datë 16.02.2016 për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor", me propozim të ABU, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen

V E N D O S I :

1.Miratimin e lejes për hapjen e një pus-shpimi për qëllime ujitje, për subjektin "Bashkia Tiranë", njësi e qeverisjes vendore nga shpuesi profesionist "NORD-COMAT" sh.p.k. Pusi do të hapet ku ndërtohet Bulevardi Verior i Tiranës për mundësinë e furnizimit me ujë për ujitje për lulishtet me këto të dhëna :

Pusi Nr.2B-2018

Koordinatat e grykës së pusit të projektuar në sistemin KRGJSH:

X= 484358.449; Y= 4579224.860; Z=105 m

- Kapaciteti i parashikuar 0,5 l/s
 - Thellësia e shpimit të parashikuar 100 m
 - Diametri i shpimit të pusit 244 mm
 - Qëllimi i përdorimit Ujitje
2. Mbyllet e çimentuar të pjesës së sipërme të pusit sipas rekomandimeve të SHGJSH.
 3. Ngarkohet ABU Ishëm Erzen për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes dhe njoftimit të palës së interesuar .

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN

SEKRETAR
Dorina GAPUNI



KRYETAR
Suzana JAHOLLARI

